



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL



Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **18.02.2025**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, **z. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **dytë (2)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë” në kategorinë: Monument i Natyrës në Komunën e Rahovecit;
3. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.6.2020, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.2.2021 dhe Rregulloren 01 Nr. 22/23 të datës 28.2.2023;
4. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025;
5. Të ndryshme.

Shtesë: Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit me Nr. Protokol 01 Nr.280/24 i datës 16.12.2024;

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, e kemi një pikë shtesë që ka të bëjë me vendimin për plotësim-ndryshimin e vendimit me Nr. Protokol 01 Nr.280/24 i datës 16.12.2024. Këtë pikë do ta prezentojë drejtori Afrim Oruqi.

Afrim Oruqi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, e kemi plotësim-ndryshimin e vendimit me Nr. Protokol 01 Nr.280/24 i datës 16.12.2024. Në takim me komision e kemi pa të arsyeshme që ta plotësojmë dhe ndryshojmë vendimin, sepse në vendim nuk e kemi paraparë çmim. Çminin edhe pse e kemi përmendur që përcaktohet me rregulloren për taksa dhe tarifa, mirëpo, sipas praktikës për të njëjtat parcela në zonën e njëjtë ka dështuar dy herë ankandit publik, sepse del të jetë shtrenjtë me 5 centë për m² për muaj. Ne kërkojmë nga ju që ta plotësoni dhe ndryshoni këtë vendim, që përmes ankandit publik t’i japim me qera këto 2 ha e 50 ari. Përveç kësaj, e kemi paraparë një paragraf që pagesa për muaj do të filloj pas 24 muajve. Ju propozojmë juve 2.5 centë për m² për muaj dhe një afat për 24 muaj, deri sa të fillojë veprimtarinë biznesi.

Burim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, për ekzekutivin dhe kolegët e KPF-së. Drejtor, parcela i ka 25.000 m², sipas vendimit paraprak të cilin po e ndryshojmë. Nëse e përpjesëtojmë me 625 i bie më pak se 2.5 centë. Faktikisht 25.000 nëse e pjesëtojmë me 650€ i bjen 3 centë. E dyta, nëse rregullorja e ka 5 centë dhe ne e propozojmë që të jetë 2.5 centë, a jemi në rregull ligjërisht? A ka mundësi të kthehet dhe të thuhet që jeni nën tarifën që e keni përcaktuar si prag minimal me rregulloren komunale dhe si e tillë të jetë joligjore dhe ne përsëri ta

shfuqizojmë ose ndryshojmë vendimin. Përndryshe, jemi në rregull në kuptimin e asaj që të jepet në shfrytëzi. Le të investohet.

Afrim Oruqi: Në propozimin për çmim, mund ta korrektojmë këtë 625€ për muaj, do ta kontrollojmë. Ju propozojmë 2.5 centë për m² për muaj, kjo është ideja. Sa i përket asaj se a jemi në rregull me çmim, i kemi dy raste në kuvend që i kemi marrë vendimet dhe ka ardhur ligjshmëria. Rastin e fabrikës së kartonit. Aty kemi vendosur çmim më të ulët se që përfaktohet me rregullore për taksa dhe tarifa dhe ligjshmëria ka ardhur në rregull. Vendimi tjetër ka të bëjë me vendimin për panele solare. Këtu gjithashtu kemi caktuar tarifa më të ulta, se sa që janë të paraparë në rregulloren për taksa dhe tarifa. Besojmë shumë që edhe këtij vendimi do t'i vijë ligjshmëria.

Defrimi Kafexhiu: Faleminderit! Përsëritet për të gjithë! E kam një pyetje, meqenëse në pikën 2 të vendimit, po ceket edhe çmimi fillestar e që është më i ulët se sa në rregullore. Pyetja është për drejtorin se a po përdoren standarde të dyfishta varësisht prej nevojës dhe të interesuarve për ta marrë pronën e komunës në shfrytëzim? Kemi raste të mëhershme ku të interesuarit nuk ka mundur ta marrin pronën, për shkak të çmimit të lartë të qeras sipas rregulloreve aktuale. Kjo është arsyeja që ata e kanë humbur interesin që ta marrin pronën e komunës në shfrytëzim. Pse kjo mënyrë nuk është zbatuar edhe në kërkesat tjera më herët, që kanë qenë për marrjen e pronave në shfrytëzim? A po përdoren standarde të dyfishta?

Afrim Oruqi: Nuk ka standard të dyfishtë në momentin kur nuk ka kërkesë. Ende nuk dimë a ka kërkesë, apo jo! Anëtarët e këtij kuvendi, kanë qenë bashkë me neve kur kemi pasur dështim të ankandit. Këtë po e bëjmë për shkak të frikës dhe përvojës së kaluar që po del shtrenjtë, shtrenjtë dhe më pas nuk ka të interesuar. Ata që mendojnë që kanë qenë të prekur përmes këtij vendimi, përmes teje i ftoj që të aplikojnë, sepse ankandi nuk është hapur ende dhe atë padrejtësi që ti po e mendon, ne e bëjmë drejtësi.

Kryesuesi: Faleminderit! A kemi edhe diçka tjetër? Nëse jo, atëherë pikën shtesë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht me 7 vota, votohet pika shtesë e rendit të ditës. Tani e vendosim rendin e ditës në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht me 7 vota, votohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht me 7 vota, votohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë” në kategorinë: Monument i Natyrës në Komunën e Rahovecit:

Afrim Oruqi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë” në kategorinë: Monument i Natyrës në Komunën e Rahovecit. Materiali është shumë voluminoz dhe do të kujdesem që në vija të trasha ta shpjegoj për juve dhe për qytetarët. Bashkë me këtë material e keni një ekspertizë profesionale nga ministritë përkatëse. Prej Komunës së Rahovecit janë të përfshira dy drejtori, e Urbanizmit dhe e Kadastrës. Është bërë një vlerësim profesional për dy zona, në Xërxë dhe në Gexhë. Në secilën pikë, prej nenit 2 i kemi të përmendura parcelat me numra dhe me sipërfaqe. Këtu e keni një hartë dhe zonën aktuale të mbrojtur dhe zonën e propozuar sipas këtij raporti të këtij komisioni profesional. Në këtë material gjithashtu e keni edhe pëlqimin prej Ministrisë së Mjedisit, të cilët na kanë thënë neve që ekspertiza është në rregull dhe vazhdoni punën në kuvend për të marrë vendim për ngushtimin e zonës së mbrojtur. Në nenin 3 i keni të përmendura parcelat të cilat mbesin në zonë të mbrojtur. Me këtë vendim do të shfuqizohet vendimi me numër 01 Nr. 352/13 i datës 09.04.1986. Në kuvend do ta prezentojmë hartën edhe parcelat.

Burim Krasniqi: Drejtor, e kemi situatën e njëjtë sikur në seancën e fundit kur e kemi pasë propozimin. Në qoftëse i referohesh hartës së zonës së propozuar për mbrojtje, pjesa e Gradishit në të dy anët është pjesë e zonës së mbrojtur (me të gjelbërt). Në elaboratin e komisionit profesional, nëse e shikojmë propozim-vendimin në fillim dhe i lexojmë parcelat që do të jenë në zonë të mbrojtur, e kemi situatën e njëjtë të mëhershme ku në mes të Gradishit janë ato sipërfaqe të papërfshira në zonën e mbrojtur. P-00772-12, 772-5, 772-4, 772-2, 772-8 dhe 772-6, janë jashtë vendimit për zonën e mbrojtur. Diçka nuk është në rregull, nuk mund të jetë Gradishi, pjesa e Xërxës që prej Obeliskut deri te Ura e Fshejtë zonë e mbrojtur dhe në mes të dalin mbi 2ha që nuk janë zonë e mbrojtur. Është joetike t'i përmendi emrat e pronarëve. Të kërkoj që në këtë propozim të futen edhe këto 4 parcela në zonë të Gradishit, ose mund të rekomandoj edhe diçka tjetër. Ta nxjerrim një zonë prej rrugës, Xërxë-Gjakovë që e përfshin Gradishin dhe prej Obeliskut deri te restorati të jetë jashtë zonës së mbrojtur, që të lejohet ndërtimi për formate specifike të cilat i lejon edhe vetë Agjencioni për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Jo të jetë në mes një parcelë prej mbi 2ha jashtë zonës së mbrojtur. Krahasojë figurën 4 të elaboratit, harta e propozuar dhe shikojë propozim-vendimin, janë 7 parcela në

mes të Gradishit që nuk janë të përfshira në zonë të mbrojtur. Pa dashur të dukem i vrazhdë, por do t'i drejtohem edhe agjencionit edhe ministrisë nëse kanë thënë që elaborati është në rregull, si të jetë në rregull kur propozim-vendimin ndryshon prej elaboratit?! Propozoj që, nëse është interes i komunës që të zhvillohet turizmi, agro-turizëm apo hotelieri në atë pjesë, le të nxjerrët një zonë 50m prej rrugës përpejtë Gradishit dhe le të bëhet e barabartë dhe korrekt për të gjithë ata që mund të bëhen pronarë në atë zonë dhe jo të nxjerret një parcelë në mes të Gradishit.

Afrim Oruqi: Arsyeshmëria profesionale për rikategorizimin e monumentit të natyrës të Kanionit të Drinit të Bardhë, ka marrë vulën e ministrive përkatëse. Kemi marrë pëlqim për arsyeshmëri në bazë të ligjeve që i kërkon kjo fushë. Të gjitha çështjet e ngritura nga asambleisti Burim Krasniqi do t'i shqyrtojmë pas këtij takimi. I kontrollojmë parcelat dhe zonat. Është me rëndësi që, kjo hartë e propozuar sipas komisionit, në faqe 12 fig.4, kjo është ligj për neve. Draftin e propozim-vendimit mund ta ndryshojmë, mirëpo këtë hartë nuk mund ta ndryshojmë, sepse ata e kanë bërë në bazë të ligjit.

Burim Krasniqi: Drejtor, mos të keqkuptohemi. Unë jam “për” korrektimit të zonës së mbrojtur, sepse me vendimin e dikurshëm, del përtej arsyes së sipërfaqes së zonës së mbrojtur. Jam i interesuar gjithashtu të nxerrim një parim, kur një pjesë e rregullojmë e një tjetër jo. Në qoftëse bazohemi te harta, në rregull jemi, por krahasojeni propozim-vendimin me hartën nr.4, asgjë më tepër. Pres që në seancë ta kemi në projektor, sepse është një vendim me shumë peshë dhe në interes të zhvillimit të komunës. Kanioni i Drinit të bardhë është moment që del nëpër video në çdo fushatë promovuese.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse nuk kemi diçka tjetër, pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (7) votohet pika e dytë e rendit të ditës.

Burim Krasniqi: Votohet me mirëkuptim, me arsyetimin që propozim-vendimi të krahasohet me elaboratin dhe në seancën e radhës ta kemi propozim vendimin konform elaboratit.

2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.6.2020, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 të datës 26.2.2021 dhe Rregulloren 01 Nr. 22/23 të datës 28.2.2023:

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KPF-së! Megjithatë nuk jam i përgatitur për këtë pikë, sepse nuk e kam ditur. Kjo pikë i përket Drejtorisë së Shëndetësisë, sepse përfshihen punojësit e Ekoregjionit dhe zjarrfikësit. Vendimi ka të bëjë që këta të lirohen prej shërbimeve në shëndetësi.

Burim Krasniqi: Meqenëse jemi duke e nxjerrë një vendim për dy kategoritë më të ndihshme që i kemi në komunë të Rahovecit, a mund të diskutohet deri në seancë me zjarrfiksat edhe për nevoja të tjera dhe kur të marrim vendim t'i lirojmë edhe prej shumë shërbimeve tjera. T'i shohim mundësitë që për punëtorët e Ekoregjionit dhe zjarrfikësit, përveç pjesë shëndetësore që mund të lëndohen gjatë punës, me një vendim nëse kemi hapësirë t'i lirojmë në më shumë gjëra këto dy kategori.

Nënkryetari: I nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë, përfaqësues të KFOR-it. Nuk e di a kemi kohë, sepse materiali për kuvend dorëzohet sot, eventualisht nesër. Sidoqoftë, do të diskutojmë me ata nëse eventualisht do të ketë ndonjë lehtësi shtesë.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash (7) votohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i informatës së DKA-së për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2024/2025:

Avni Morina: Përshëndetje i nderuar kryesues, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së, përfaqësues të KFOR-it. Në këtë informatë i kemi pasqyruar aktivitetet, punët dhe angazhimet që i ka pasur DKA-ja nga data 2 shtator 2024, ku ka filluar viti i ri shkollor, deri më 24 dhjetor 2024, ku ka përfunduar gjysmëvjetori i parë i këtij viti shkollor. Jemi munduar t'i pasqyrojmë të gjitha aktivitetet gjatë kësaj periudhe. Informatën e keni pranuar përmes Sekretarisë së Kuvendit dhe nëse keni pyetje jam këtu dhe do ta shqyrtojmë për kuvend.

Burim Krasniqi: Drejtor, kjo informatë që po na vjen çdo herë është vetëm për punët që i ka bërë DKA-ja, por jo për arsimin dhe jo për mbylljen e gjysmëvjetorit. Nuk kemi informatë sa mungesa të nxënësve janë? Sa mungesa të arsimtarëve? A ka sfida? Në hoçë të vogël nuk ka arsimtar të matematikës, në gjimnaz poashtu! Është informatë e gjysmëvjetorit dhe nuk është informatë e punës së DKA-së. E kemi nxjerrë edhe një vendim për arsimin joformal, sa ka qenë interesimi? Ta kompletosh si aktivitet të gjysmëvjetorit dhe jo të punës së DKA-së. Pres dhe besoj që në seancë informata të jetë e kompletuar. Nuk besoj që ka ndonjë “sekret” që duhet të mbahet prej asamblesë. Duhet ta bëjmë bashkë edhe për çdo telashe, gjithmonë për të mirën e arsimit në komunë të Rahovecit.

Shqipe Kryeziu: Faleminderit kryesues! Përderisa i përkas fushës së arsimit, mendoj njëjtë. Drejtor, informata nuk m'u duk hiç. Së pari nuk e keni cekë mësimin joformal në IAAP. Ne nga këtu e kemi marrë atë vendim, e kemi përkrah. A është duke vazhduar? si është duke vazhduar? A ka çalim? Nëse po, pse?... Në kuvend presim një informatë më të saktë. Te tri çerdhet informata është në fija të ngushta, të zgjerohet më shumë.

Avni Morina: Faleminderit për sugjerimet! Pajtohem plotësisht që informata nuk i ka përfshirë të gjitha atë që duhet të përfshihen. Unë nuk mbaj fshehur asgjë sa i përket sfidave që i kemi. Në fillim kur e prezentova e thash që, janë pasqyruar të gjitha aktivitetet e DKA-së, prej 2 shtatorit deri më 24 dhjetor. Jam prej atyre të rrallëve të drejtorave të arsimit që edhe në fejsbuk kam bërë thirrje për mësimdhënës të matematikës. Do t'i pasqyrojmë sfidat dhe mungesat e mësimdhënësve që janë bërë gjatë kësaj periudhe. Kjo është informatë dhe nganjëherë frikësohet që mos po dal në raport, sepse po të zgjerohet tepër del raport.

Burim Krasniqi: Drejtor, mos e merr shumë shkurt! E para, nuk të thash që je duke mbajtur diçka të fshehtë, sepse nëse është ashtu, unë drejtohem me shkresë zyrtare për qasje në dokumente zyrtare dhe e keni obligim ligjor të ma jepni atë informatë. E dyta, çdo herë është thënë "raport", po e kemi ndërruar në "informatë" me qëllim që raportet votohen, ndërsa informatat jo. Përndryshe, është obligim i ekzekutivit që informata të jetë e plotë për kuvend komunal.

Avni Morina: Do t'i përfshi të gjitha sfidat që i kemi si DKA. Ndoshta mungon mbarëvajtja e procesit edukativo-arsimor. Informata është bukur e plotë dhe unë nuk e kuptoj kolegen time, e cila thotë "hiç asgjë s'ke bë"! Më fal Shqipe, por unë jam munduar edhe t'i reduktojë, sepse kam aq shumë informata sa që të bëhej shumë faqe. Unë jam transparent.

Shqipe Kryeziu: Drejtor, me gjithë respektin, por ne e meritojmë të marrim informatë prej IAAP-së, rreth mësimi joformal. Kërkojmë që, në kuvend të kemi informatë shtesë rreth mësimi joformal, si dhe sa i përket çerdheve, sepse tri çerdhe janë pa vendim pune dhe pa ushtrues detyre.

Defrim Kafexhiu: Po më vjen mirë që pas tre viteve, në kuvend komunal ka këso lloj kritikash kundrejt drejtorit të arsimit. Forma e informatës nga Drejtoria e Arsimit për çdo gjysmëvjetor ka qenë e njëjtë dhe është interesant fakti i këtyre kritikave kundrejt kësaj drejtorie, sidomos prej anëtarëve prej pozitës.

Burim Krasniqi: Defrim, po të thërras në emër, të kërkoj falje! Sa herë ka ardh raporti, unë e kam kërkesën e njëjtë, që të jetë çdo herë i plotësuar. Shikoj procesverbalet.

Shqipe Kryeziu: Defrim, të kam pasur edhe ish-bashkëpartiak. Këtë informatë që unë e kërkoja, nuk është që tri vite, kjo është së fundi dhe është hera e parë që duhet të bëhet, ndoshta edhe i ka dalë prej mendjes drejtorit.

Nënkryetari: Nuk besoj që kjo është kritikë, është kërkesë për plotësim të informatës. Sidoqoftë edhe nëse informata apo raporti votohet apo nuk votohet, nuk prodhon kurrfarë efekti juridik më vonë. Besoj që kjo informatë duhet të jetë më e plotë dhe me përgjegjësi të plotë e them që i vetmi që i ka pasur këto kërkesa për plotësim të informatës ka qenë Burimi. Duhet të plotësohet me mungesa të nxënësve, në shkolla fillore e të mesme. Me mungesa të arsimtarëve, nëse ka mungesa, a mund t'ju ndalen mëdijtjet?... Cilat janë masat ndëshkuese? etj etj...

Defrim Kafexhiu: Mos të keqkuptohemi, sepse edhe unë pajtohem me këto kërkesa të anëtarëve të KPF-së drejt drejtorit të arsimit. Nuk e di se sa janë të sinqerta këto kërkesa! Përndryshe, sa më transparente që është Drejtoria e Arsimit dhe sa më shumë që na informon me gjendjen e DKA-së dhe të arsimit në komunë të Rahovecit është më mirë për ne. Mund të hyjmë edhe në çështjet tjera që drejtori mund të jep informatë: Çështja e punësimeve, çështja e normave mësimore, si po luan DKA-ja me normat mësimore dhe me çështjet tjera që lidhen me anëtarët e kuvendit këtu, si dhe me njerëz që kanë kaluar prej një partie në tjetrën. Sicili prej nesh, pa e parë informatën prej DKA-së, e dimë se si është gjendja e arsimit. Të gjithë pothuajse keni fëmijë që janë pjesë e këtij sistemi arsimor dhe mund ta dini përafërsisht gjendjen e funksionimit të arsimit në komunën e Rahovecit.

Nënkryetari: Kalimet të një asambleisti prej një partie në tjetrën është krejtësisht personale. Proces i natyrshëm që ka ndodhur, po ndodh dhe do të ndodh edhe në të ardhën. Te mungesa e kuadrit: Siç e dini, komuna shpall konkurs për bursa dhe në mungesën e kuadrove secili aplikant automatikisht e fiton bursën, pavarësisht ndoshta edhe të notës mesatare që përcaktohet në ato kritere. Për moment, nuk kemi si ta stimulojmë ndryshe dikë që të studiojë në këto drejtime deficitare që janë në komunën tonë.

Avni Morina: Pa dashur ta zgjas këtë çështje, unë si drejtor i DKA-së kam formuluar një informatë në bazë të dhënave që i kam në DKA, për një periudhë të caktuar. Kam folur për disa çështje me të cilat kemi marrë gjatë gjithë kësaj periudhe. Gjithashtu e kuptoj që ka nevojë të plotësohet me informata të tjera. Mirëpo, ta kërkoj një informatë tjetër dhe në anën tjetër të thua që këtë informatë e kam parë në fejsbuk, nuk është në rregull diçka. Shqipe, po të drejtohem ty "pa teklig". Në qoftëse ndonjë informatë nuk ka ndodhur brenda kësaj periudhe, atëherë këtu jam. Unë u

fokusova vetëm për një periudhë të caktuar. Do ta plotësoj me të gjitha informatat që i keni kërkuar, sepse më mirë se unë askush nuk i din këto gjëra, sepse jam drejtor i DKA-së dhe i kam informatat burimore që më kanë ardhur prej shkollave. Në gjimnaz jam detyruar ta rishpall konkursin për matematikë, 2 herë dhe nuk ka ardhur askush – nuk ka kuadro.

Shqipe Kryeziu: Drejtor, e ceke që the unë di. Ne të vlerësuam që din dhe për atë të kërkojmë informatë për mësimin për të rritur. Nuk ka nevojë të më drejtohesh personalisht. Je drejtor i DKA-së, unë jam në fushë të arsimit dhe kam nevojë të di rreth kësaj, pse nuk kemi shpall konkurs?...

5. Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit me Nr. Protokol 01 Nr.280/24 i datës 16.12.2024:

Kryesuesi: Me mirëkuptimin tuaj, vazhdojmë me pikën shtesë: Vendim për plotësim-ndryshimin e vendimit me Nr. Protokol 01 Nr.280/24 i datës 16.12.2024. Kjo pikë veçse u prezentua nga drejtori. E vendosim në votim, kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht (7) votohet pika shtesë.

6. Të ndryshme:

Burim Krasniqi: Në seancë të kuvendit, a do të jetë pika shtesë?

Kryesuesi: Një pikë shtesë që ka të bëjë me plotësim-ndryshimin e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar.

Defrim Kafexhiu: Meqenëse drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit nuk është këtu, këtë pyetje e kam për nënkryetarin. Është kërkesë që është bërë dy herë në drejtorinë e Urbanizmit që të ndërtohet një lagje. Nuk e di ku është problemi te kjo drejtori. Pala i ka bërë dy kërkesa për pajisje me kushte ndërtimore, dy kërkesat janë refuzuar dhe ndërmjet këtyre dy kërkesave ka pasur dy vendime nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe dy kërkesa i ka pasur drejt drejtorisë së Urbanizmit. Këtu është pak keq me thënë, por, ose dikujt është duke iu prishur interesi, ose dikush ka interes që mos të vazhdojë përpara. Nuk e di ku është problemi? Kjo është për të mirën e përgjithshme. Investitori është biznesmen dhe normal që ai do të fitojë, por gjithashtu është përfitim edhe i komunës së Rahovecit, nëse do të ketë projekte të tilla. Të hezitohet drejtorja e Urbanizmit dhe të tentojë ta stopojë një çështje, e cila e ka një bazë të mjaftueshme për procedim tutje, në bazë të vendimit të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe pavarësisht këtyre mos të reflektojnë? Kam qejf ta di se ku është problemi? Nëse ka mundësi, në seancën e rregullt ta kemi një informatë për këtë çështje.

Nënkryetari: Realiteti është krejt ndryshe dhe besoj që për të gjitha investimet ekzekutivi duhet të jetë më i kënaqur se sa të gjithë të tjerët. Në këtë rast, pala ka angazhuar edhe një avokat dhe për të gjitha paqartësitë hapet konflikti administrativ etj... Kur mbyllet konflikti administrativ, palët kanë të drejtë të bëjnë padi rreth paqartësive në proces. Nuk besoj që, drejtori i Urbanizmit e aq më pak kryetari i komunës është i interesuar që për ndonjë “inat” ta stopojë një investim kaq të madh. Siç e njeh investitorin ti, e njoh edhe unë, bile unë ndoshta e njoh më shumë. Besoj që të gjithë duhet të jemi të kënaqur nëse ndodh ai investim, sepse është investim milionësh.

Defrim Kafexhiu: Unë shumë pak e njoh, pothuajse hiç. Sipas informatave që unë i kam dhe sipas ankesave që i kanë bërë kundrejt vendimit të drejtorisë së Urbanizmit, është e paarsyeshme. Konfliktet administrative dhe padia në gjykatë nuk i konvenon askujt, as palës as komunës. Unë nuk jam që ligji të shkelet, asnjëherë, por nëse ka vendime të ministrisë që janë bazë e mjaftueshme që drejtorja ta procedojë tutje këtë projekt, atëherë nuk kemi pse të zhagohet.

Nënkryetari: Sa për korrektësi, një palë mendon ta realizojë një të drejtë që e ka, pala tjetër e shqyrton dhe thotë: kjo ka barriera ligjore, apo nuk ka! Është organi tjetër që mbi bazën e një ankese e trajton, përsëri vjen te organi i shkallës së parë, i cili mendon ndryshe. Nëse ekziston veç një hapësirë e vogël ligjore, ne me dy duar e me dy këmbë do t’ia japim lejen këtij investimi të madh, që mund të ndodh në komunën e Rahovecit. Ju e dini që PZhK-në e kemi miratuar dhe Hartën Zonale jemi duke e pritur me vite, ndërsa investitorët janë duke pritur për ndërtime të larta.

Kryesuesi: Faleminderit nënkryetar! Nëse nuk kemi diçka tjetër, e quaj të mbyllur mbledhjen e dytë të KPF-së.

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi



